

VENDIM
Nr.176, datë 25.5.1990

PËR FONDIN E SHPËRBLIMEVE PËR NOVACIONE E RACIONALIZIME

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Komitetit të Shkencës e të Teknikës dhe të Këshillit të Përgjithshëm të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Masa e shpërblimit të novatorëve e racionalizatorëve të jetë:
 - a) Për novacionet dhe racionalizimet me efektivitet vjetor deri në 25 mijë lekë të jetë nga 500 deri në 1000 lekë dhe, kur është grup autorësh jo më shumë se 500 lejë për person e në çdo rast jo më shumë se përfitimi vjetor i novacionit ose racionalizimit.
 - b) Për novacionet e racionalizimet me efektivitet vjetor nga 25 mijë deri në 100 mijë lekë, masa e shpërblimit të jetë deri në 2000 lekë dhe kur janë grup autorësh jo më shumë se deri në 1000 lekë për person, e në çdo rast jo më shumë se përfitimi vjetor i novacionit ose racionalizimit.
 - c) Për shpikjet e racionalizimet me efekt mbi 100 mijë lekë shpërblimi të jetë deri në 2 për qind të efektit vjetor, por jo më shumë se deri në 5000 lekë dhe për grup autorësh jo më shumë se deri në 3000 lekë për person.
2. Autorëve të novacioneve e të racionalizimeve, kur propozimi mirtohet, u jepet 20 për qind e shpërblimit, kurse pjesa tjetër u jepet pasi të jetë realizuar efektiviteti vjetor.

Pagesa e shpërblimit të autorëve bëhet nga ndërmarrja ose institucioni ku miratohet e ku realizohet përfitimi ekonomik i novacionit ose racionalizimit.
3. Për institucionet buxhetore shpërblimet për novacionet e racionalizimet përballohen nga fondi i veçantë i krijuar.
4. Komiteti i Shkencës dhe i Teknikës dhe Ministria e Financave në bashkëpunim me Këshillin e Përgjithshëm të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë, të lëshojë udhëzim për zbatimin e jëtij vendimi.
5. Ky vendim u rekomandohet për zbatim kooperativave bujqësore.
6. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.441, datë 19.12.1986 "Për përdorimin më drejt të stimujve materialë suplementarë dhe të fondit të veçantë", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ADIL ÇARÇANI